



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10 dhe 123/12), nenit 57 paragrafi (2) dhe paragrafi (3) dhe nenit 59, paragrafi (5) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10 dhe 26/13), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, miratoi

V E N D I M **për dhënien e pëlqimeve** **(Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 72/13)**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSME

1. Me këtë vendim përcaktohet:

- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit të bankës.
- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për fillimin me kryerjen e aktivitetit nga neni 7, paragrafi (1), pikat 5), 8), 9), 13), 14), 15), 16), 17), 18) dhe 23) të Ligjit të Bankave;
- dokumentet, të dhënat dhe informatat për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të tyre;
- dokumentet, të dhënat dhe informatat për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të tyre;
- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për themelimin e degës, filialit ose zyrës së përfaqësimit të bankës jashtë vendit ose për fitimin e pjesëve të kapitalit në bankë;
- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për themelimin ose marrjen e një pjese të kapitalit në institucionin financiar jobankar ose në institucionin jofinanciar, direkt ose indirekt, që është mbi 10% nga fondet e veta të bankës;
- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për hapjen e zyrës së përfaqësimit të bankës së huaj;
- lloji i dokumentacionit, mënyra e dorëzimit të saj dhe kushtet dhe procedura për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për ndryshimin e emrit dhe selisë së bankës;
- dokumentet, të dhënat dhe informatat për dhënien e pëlqimit të mëparshëm për fitimin e aksioneve në bankë, shuma nominale kumulative e së cilës arrin ose tejkalon 5%, 10%, 20%, 33%, 50% dhe 75% të numrit të përgjithshëm të aksioneve, gjegjësisht të numrit të përgjithshëm të aksioneve të emetuara me të drejtë vote, mënyrën e dorëzimit të tyre, si dhe mënyrën dhe procedurën e vlerësimit të tyre.

II. DHËNIA E PËLQIMIT PËR NDRYSHIMIN DHE/OSE PLOTËSIMIN E STATUTIT TË BANKËS

2. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit të bankës, banka dorëzon:

- vendimin e asamblesë së bankës për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit, i cili do të hyjë në fuqi pas dhënies së pëlqimit nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: guvernatori) ose Propozim-vendimin e Këshillit të Mbikëqyrjes për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit, i cili do të hyjë në fuqi pas miratimit të ndryshimit dhe/ose plotësimit të statutit nga asambleja e bankës dhe pas dhënies së pëlqimit nga guvernatori;

- Propozim-teksti i ndryshimit dhe/ose plotësimit të statutit të bankës;
- arsyetimi i nevojës për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit të bankës;
- tekstin e konsoliduar të statutit në të cilin do të shënohen ndryshimet dhe/ose plotësimet për të cilët kërkohet pëlqimi.

3. Gjatë vendimmarrjes pas kërkesës nga pika 2) e këtij vendimi, vlerësohet nëse ndryshimi dhe/ose plotësimi i propozuar i statutit është në pajtim me rregullat ligjore dhe standardet mbikëqyrese të përcaktuara.

4. Në bazë të vlerësimit nga pika 3) e këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit për ndryshimin dhe/ose plotësimin e statutit të bankës ose për refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

III. DHËNIA E PËLQIMIT PËR FILLIMIN E KRYERJES SË AKTIVITETIT NGA NENI 7, PARAGRAFI (1), PIKAT 5), 8), 9), 13), 14), 15), 16), 17), 18) DHE 23) TË LIGJIT TË BANKAVE.

5. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për fillimin e kryerjes së aktivitetit nga neni 7, paragrafi (1), pikat 5), 8), 9), 13), 14), 15), 16), 17), 18) dhe 23) të Ligjit të Bankave (në tekstin e mëtejshëm: aktiviteti i ri financiar), banka dorëzon:

5.1. Elaboratin për arsyeshmërinë për fillimin me kryerjen e aktivitetit të ri financiar, në të cilin duhet të shtjellohen arsyet, qëllimet dhe rezultatet e pritshme financiare.

5.2. Emrin e pjesës organizative që do të jetë bartës i aktivitetit të ri financiar dhe vendosjen e tij në kuadër të strukturës organizative të bankës.

5.3. Të dhëna për numrin dhe arsimin e personave që do të përfshihen në kryerjen e aktivitetit të ri financiar, si dhe identitetin, arsimin dhe përvojën e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta, në kompetencë të së cilës do të bëhet kryerja e aktivitetit të ri financiar (formulari 5).

5.4. Të dhënat për sistemin informativ dhe pajisjet teknike të bankës që do të përdoren gjatë kryerjes së aktivitetit të ri financiar, me ç'rast:

- dokumentacioni për sistemin informativ duhet të bazohet në minimum

standardet për siguri të sistemit informativ dhe për sigurimin e punës së pandërprerë, në pajtim me Vendimin për sigurinë e sistemit informativ të bankës. Nëse është parashikuar funksionimi i aktivitetit të ri financiar të varet nga përdorimi i shërbimeve nga personat e jashtëm (Shoqëri për shërbime ndihmëse të bankës), dorëzohen të dhënat përkatëse për aplikimin e standardeve të sigurisë së sistemit informativ dhe për sigurimin e pandërprerë në punën e atyre personave;

- dokumentacioni për pajisjen teknike duhet të përmbajë të dhëna për hapësirën afariste ku do të punojë banka (vetë, me qira, vendndodhja, sipërfaqja dhe dinamika e pajisjeve të saj për ta lëshuar në përdorim) dhe për pajisjet teknike që do të përdoren në kryerjen e aktivitetit të ri financiar. Banka duhet të dorëzojë dokumentacion për karakteristikat bazë të serverëve, lidhshmëria komunikuese dhe bazat e të dhënave që do të përdoren në kryerjen e aktivitetit të ri financiar, si dhe për mënyrën e funksionimit të komponentëve kryesorë të sistemit informativ dhe të zgjidhjeve aplikative.

5.5. Propozim-politikat dhe aktet interne për kryerjen e aktivitetit të ri financiar, si dhe procedurat për sistemin e kontrollit të brendshëm, aktivitetet e auditimit të brendshëm në kuadër të pjesës organizative që do të kryejë aktivitetin e ri financiar dhe procedurat për përfshirjen përkatëse të aktivitetit të ri financiar në procesin e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

5.6. Parashikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve në lidhje me kryerjen e aktivitetit të ri financiar, për tre vitet e ardhshme. Parashikimet duhet të përmbajnë koment për secilën kategori të veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe supozimet bazë në të cilat ato bazohen.

5.7. Dëshmi për lejen ose pëlqimin e marrë nga institucioni kompetent ose mendim të marrë nga organi kompetent, nëse një leje, pëlqim ose mendimi i tillë janë parashikuara me ligj tjetër.

6. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për dhënien e parasë elektronike, përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon edhe:

- planin për auditimin e brendshëm të atij aktiviteti, së paku për dy vitet e para të kryerjes së saj;

- të dhënat dhe informatat e tjera në pajtim me Vendimin për kushtet dhe mënyrën e punës së shoqërisë për dhënien e parave elektronike.

7. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për kryerje të qarkullimit pagesor në vend dhe qarkullimit pagesor jashtë vendit, duke përfshirë edhe blerjen dhe shitjen e valutës së huaj (në tekstin e mëtejme: qarkullimi pagesor jashtë vendit), përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon:

- të dhënat për personin me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që do të jetë përgjegjës për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend, gjegjësisht për qarkullimin pagesor jashtë vendit, i cili duhet të ketë së paku pesë vjet përvojë në punën bankare, prej të cilave së paku tre vjet në qarkullimin pagesor në vend, përkatësisht në qarkullimin pagesor jashtë vendit (formulari 5);

- tarifat për shërbimet në qarkullimin pagesor;
- planin për auditimin e brendshëm të atij aktiviteti, së paku për dy vitet e para të kryerjes së saj.

Politikat dhe aktet interne të nënplikës 5.5 të këtij vendimi për kryerjen e qarkullimit pagesor duhet të përmbajnë së paku:

- procedurën për mënyrën e kryerjes së qarkullimit pagesor të brendshëm dhe të qarkullimit pagesor ndërbankar;
- procedurën për hapjen e llogarive të depozituesve për kryerjen e qarkullimit pagesor në vend;
- planin afatshkurtër për punë me pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor;
- mënyrën e komunikimit me pjesëmarrësit në qarkullimin pagesor.

Kërkesës për dhënien e pëlqimit për kryerjen e qarkullimit pagesor me vendet e huaja, përveç dokumentacionit nga paragrafi (1) i kësaj pike dhe pika 5) e këtij vendimi, banka dorëzon edhe dëshmi për fillimin e procedurës për t'u bashkangjitur në SWIFT (S.W.I.F.T.).

8. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për transferim të shpejtë të parave, përveç dokumentacionit nga pika 5) e këtij vendimi, banka e dorëzon edhe dokumentacionin e përcaktuar nga Banka Popullore për dhënien e pëlqimit për kryerjen e transferimit të shpejtë të parave.

9. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për tregtim me mjete valutore (që përfshin tregtim me metale të çmuara), tregtim me letra me vlerë dhe tregtim me derivate financiare, përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon dhe:

9.1. Strategjinë për investim e cila sa paku përfshin: përshkrimin e instrumenteve të dukshme me të cilat do të tregtohet, niveli i pranueshëm i rrezikut, vëllimi i tregtimit të planifikuar me çdo instrument, mënyrën e kryerjes së testimit të stresit, si dhe përkufizimin e sistemit të kufijve të ekspozimit dhe/ose kufijve të humbjes së lejueshme për:

- çdo rrezik të veçantë ndaj të cilit do të ekspozohet banka me kryerjen e aktivitetit të ri financiar;
- çdo pjesë organizative të veçantë që do të përfshihet në kryerjen e aktivitetit të ri financiar;
- çdo instrument të veçantë (letra me vlerë, derivat financiar) me të cilin banka do të tregtojë;
- çdo person i cili do të kryejë tregtim në emër dhe në llogari të bankës.

9.2. Procedurat për procesin e vendimmarrjes dhe përgjegjësitë e personave të veçantë të përfshirë në atë proces, duke përfshirë edhe procedurat për mënyrën e vendimmarrjes në rast të tejkalimit të kufijve të përcaktuara.

9.3. Të dhënat për mënyrën e kufizimit funksional ndërmjet pjesës organizative që do të kryejë aktivitetin e ri financiar dhe pjesët tjera të bankës, nga aspekti i mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave dhe shmangies së konfliktit të interesit.

9.4. Të dhënat për kufizimin e funksionit të pranimit dhe zbatimit të

urdhëresave për tregtim (ang. front office) nga funksioni i lidhjes së urdhëresave për tregtim (ang. back office), si dhe për kufizimin e linjave të raportimit në organet kompetente për menaxhim, lidhur me këto dy funksione të veçanta.

9.5. Planin e auditimit të brendshëm të aktivitetit të ri financiar, së paku për dy vitet e para të kryerjes së saj.

Kërkesës për dhënien e pëlqimit për tregtim me mjetet valutore (që përfshin tregtim me metalet e çmuara), tregtim me letrat me vlerë dhe tregtim me derivate financiare jashtë vendit, banka dorëzon dhe:

- certifikatën për punën në tregjet financiare për punonjësit që do të kryejnë aktivitetin e ri financiar, dhe atë së paku ACI certifikatë për tregtim (ACI Dealing Certificate) të destinuar për punonjësit në pjesën e pranimi dhe zbatimit të urdhëresave dhe ACI certifikatë për shlyerje (ACI Settlement Certificate) të destinuar për punonjësit në pjesën e lidhjes së urdhëresave për tregtim;
- dëshmitë e posedimit të sistemit elektronik të unifikuar për qasje në informatat e tregut të parasë, letrat me vlerë dhe tregu valutor në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Banka Popullore e organizon unifikimin e sistemit elektronik për qasje në informatat e tregut të parasë, letrave me vlerë dhe tregut valutor në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
- dëshmitë për procedurën e filluar për t'u bashkëngjitur me SWIFT, nëse banka kryen tregtim me mjetet valutore (që përfshin tregtim me metalet e çmuara), tregtim me letrat me vlerë, tregtim me derivate financiare jashtë vendit.

10. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për menaxhim me mjetet dhe portfoliot e letrave me vlerë për klientët dhe/ose këshillimin e investimit të klientëve, përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon dhe:

- të dhënat për mënyrën e kufizimit funksional ndërmjet pjesës organizative që do të kryejë aktivitetin e ri financiar dhe pjesëve të tjera të bankës, nga aspekti i mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave dhe shmangies së konfliktit të interesit.
- shembullin e kontratës së standardizuar për menaxhim me mjetet dhe portfoliot e letrave me vlerë për klientët dhe/ose këshillimin e investimit të klientëve që përmban të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve kontraktuese, duke përfshirë edhe mënyrën e mbulimit të dëmit të shkaktuar për fajin e bankës;
- certifikatën për këshillimin e investimit për punonjësit që do të kryejnë aktivitetin e ri financiar;
- dëshmitë për posedimin e sistemit elektronik për qasje në informatat në tregjet financiare dhe atë: "Rojters" (Reuters), "Bllumberg" (Bloomberg) ose "Tenfor" (Tenfore);
- dëshmitë e procedurës së nisur për t'u bashkëngjitur në SWIFT, nëse banka, gjatë kryerjes së aktivitetit, menaxhimin me mjetet dhe portfoliot e letrave me vlerë për klientët, kryen tregtim jashtë vendit.

11. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për ofrimin e shërbimeve të ruajtjes së pronës për fondet e investimeve dhe pensione, përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon dhe:

- dëshmitë për procedurën e filluar për t'u bashkëngjitur në SWIFT;

- të dhënat për mënyrën e kufizimit funksional ndërmjet pjesës organizative që do të kryejë aktivitetin e ri financiar dhe pjesëve të tjera të bankës, nga aspekti i mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave dhe shmangies së konfliktit të interesave, sidomos në aspektin e kufizimit me pjesët organizative që kryejnë tregtim me letrat me vlerë dhe menaxhimin me mjetet dhe portofoliot e letrave me vlerë për klientët dhe/ose këshillimin e investimit për klientët;

- shembullin e kontratës së standardizuar për ofrimin e shërbimeve për ruajtjen e pronës për fondet e investimeve dhe pensione, ku do të përmbahen të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të palëve kontraktuese, duke përfshirë mënyrën e mbulimit të dëmit të shkaktuar për fajin e bankës;

- të dhënat për kufizimin e linjave të raportimit deri te organet kompetente të menaxhimit me pjesët e tjera organizative, sidomos në aspektin e kufizimit të linjave raportuese me pjesët organizative që kryejnë tregtim me letrat me vlerë dhe menaxhimin me mjetet dhe portofolio të letrave me vlerë për klientët dhe/ose këshillimin e investimit për klientët.

12. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për kryerjen e blerjes dhe shitjes, garantimin ose vendosjen e emetimit të letrave me vlerë, përveç dokumentacionit të pikës 5 të këtij vendimi, banka dorëzon dhe:

12.1. Strategjinë e blerjes dhe shitjes, garantimin ose vendosjen e emetimit të letrave me vlerë që përmban së paku: përshkrimin e shërbimeve që do të ofrojë banka, në lidhje me aktivitetin e ri financiar, nivelin e pranueshëm të rrezikut, vëllimin e planifikuar të blerjes dhe shitjes, garantimin ose vendosjen e emetimit të letrave me vlerë, mënyrën e kryerjes së testimit të stresit, si dhe përkufizimin e sistemit të kufijve të ekspozimit dhe/ose kufijve të humbjeve të lejuara për:

- çdo rrezik të veçantë ndaj të cilit do të ekspozohet banka me kryerjen e aktivitetit të ri financiar;

- çdo pjesë organizative të veçantë që do të përfshihet në kryerjen e aktivitetit të ri financiar.

12.2. Procedurat për procesin e vendimmarrjes dhe përgjegjësitë e personave të veçantë të përfshirë në atë proces, duke përfshirë procedurat dhe mënyrën e vendimmarrjes në rast të tejkalimit të kufijve të përcaktuar.

12.3. Të dhënat për mënyrën e kufizimit funksional ndërmjet pjesës organizative që do të kryejë aktivitetin e ri financiar dhe pjesëve të tjera të bankës, nga aspekti i mbrojtjes së konfidencialitetit të të dhënave dhe shmangies së konfliktit të interesave.

12.4. Plani i auditimit të brendshëm të aktivitetit të ri financiar, së paku për dy vitet e para të kryerjes së saj.

13. Gjatë vendimmarrjes në lidhje me kërkesën për dhënien e pëlqimit për fillimin e kryerjes së aktivitetit të ri financiar, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejme: Banka Popullore) vlerëson nëse banka do të jetë e organizuar dhe e aftë të punojë në pajtim me rregullat ligjore dhe standardet e përcaktuara mbikëqyrëse, ku duhet marrë parasysh së paku kriteret në vijim:

- banka posedon nivelin e përcaktuar të mjeteve të veta të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të ri financiar;

- ekziston justifikimi ekonomik për fillimin me kryerjen e aktivitetit të ri financiar;

- banka ka strukturë të përshtatshme të punonjësve për kryerjen efektive dhe të suksesshme të aktivitetit të ri financiar. Përshtatshmëria e strukturës së punonjësve vlerësohet nëpërmjet numrit të nevojshëm të punonjësve për kryerjen e aktivitetit të ri financiar, kualifikimet e tyre, si dhe nëpërmjet përshtatshmërisë së kualifikimeve të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që do të jenë përgjegjës për kryerjen e aktivitetit të ri financiar.

Numri i nevojshëm i punonjësve është ai numër që ofron siguri se banka do të kryejë në mënyrë të rregullt dhe normale vëllimin e planifikuar të aktivitetit të ri financiar. Përshtatshmëria e kualifikimeve të punonjësve dhe personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta nënkupton posedimin e njohurive të nevojshme, ekspertizë dhe përvojë për kryerjen e detyrave të duhura në lidhje me aktivitetin e ri financiar;

- do të ekzistojë kufizim funksional ndërmjet kryerjes së aktivitetit të ri financiar dhe pjesët tjera të aktiviteve të bankës, si dhe kufizimi ndërmjet linjave të raportimit tek organet kompetente për menaxhim;

- do të sigurohet kontrolli i dyfishtë në kryerjen e aktivitetit të ri financiar, gjegjësisht nuk do të jetë e mundur një person t'i kryejë të gjitha fazat në një transaksion, duke përfshirë edhe regjistrimin kontabël të saj (kjo është veçanërisht e rëndësishme kur tregton me valutë të huaj, tregton me letra me vlerë, tregtimi me derivate financiare, menaxhimi i mjeteve dhe portofolit të letrave me vlerë për klientët dhe/ose këshillimin e investimit të klientëve, ofrimi i shërbimeve të ruajtjes së pronës për fondet e investimeve dhe pensione dhe blerjes dhe shitjes, garantimi ose vendosja e emetimit të letrave me vlerë);

- banka ka sistem informativ të përshtatshëm dhe pajisje teknike për kryerjen e suksesshme dhe të sigurt të aktivitetit të ri financiar. Sistemi informativ konsiderohet si adekuat nëse i plotëson standardet e përcaktuara në Vendimin për sigurinë e sistemit informativ të bankës, ofron vazhdimësi në veprimtarinë dhe i plotëson kriteret e përcaktuara në këtë vendim të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të ri financiar, duke mundësuar mbështetje të vazhdueshme dhe të sigurt të aktivitetit të ri financiar të bankës ofron bazë për raportim në kohë dhe të saktë të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të Bankës Popullore. Banka duhet të posedon hapësirë adekuate afariste dhe pajisje teknike që do të mundësojnë kryerjen e sigurt dhe të pandërprerë të aktivitetit të ri financiar;

- aktiviteti i ri financiar do të përfshihet në mënyrë adekuate në sistemin e kontrollit të brendshëm, në auditimin e brendshëm dhe në sistemin e parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit;

- përshtatshmëri të politikave dhe procedurave të vendosura për kryerjen e aktivitetit të ri financiar, veçanërisht nga aspekti i mundësisë së menaxhimit adekuat me rreziqet ndaj të cilave do të ekspozohet banka si rezultat i aktivitetit të ri financiar;

- do të përkufizohet qartë roli i personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta që do të jenë kompetent për miratimin e vendimeve dhe mbikëqyrjen e kryerjes së aktivitetit të ri financiar;

- banka ka kapacitet për menaxhimin me rreziqet ndaj të cilave do të ekspozohet gjatë kryerjes së aktivitetit të ri financiar;

- në kërkesën nuk ekzistojnë mospërputhje që nuk mund të shpjegohen.

Gjatë vlerësimit nga paragrafi 1 të kësaj pike, merret parasysh edhe shkalla

e harmonizimit të bankës me rregullat që rregullojnë veprimtarinë e bankave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe shkallën e respektimit të masave të shqiptuara nga Banka Popullore.

14. Në bazë të vlerësimit të pikës 13) të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit për fillimin e kryerjes së aktivitetit të ri financiar ose refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

15. Nëse gjatë vendimmarrjes konstatohet se nevojitet normë më e lartë e mjaftueshmërisë së kapitalit për shkak të natyrës, llojit dhe vëllimit të aktiviteteve që i kryen banka dhe rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar si rezultat i atyre aktiviteteve, duke përfshirë edhe aktivitetin e ri financiar, guvernatori mund të miratojë aktvendim për dhënie të pëlqimit për kryerjen e aktivitetit të ri financiar dhe në të njëjtën kohë të kërkojë nga banka të arrin nivelin e nevojshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit në periudhë kohore të përcaktuar saktësisht.

Banka do të mund të fillojë të kryejë aktivitetin e ri financiar vetëm nëse e arrin normën e nevojshme të mjaftueshmërisë së kapitalit në afat të përcaktuar në paragrafin 1 të kësaj pike.

Në rastet kur guvernatori do të vlerësojë se nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e pëlqimit për kryerjen e aktivitetit të ri financiar, ose nëse bankës i është hequr pëlqimi për kryerjen e aktivitetit financiar, banka mund të parashtrojë kërkesë të re për dhënien e pëlqimit vetëm pas skadimit të afatit prej një viti nga dita e refuzimit të kërkesës, gjegjësisht nga dita e tërheqjes së pëlqimit.

IV. DHËNIA E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS

16. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, banka dorëzon:

16.1. Vendimin e asamblesë së bankës për emërimin e anëtarit të propozuar të Këshillit Mbikëqyrës, i cili do të hyjë në fuqi pas dhënies së pëlqimit nga guvernatori. Në vendimin theksohet periudha për të cilën emërohet anëtari i propozuar, duke pasur parasysh dispozitat e Ligjit të Bankave dhe statutin e bankës, të cilat i referohen kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

16.2. Të dhënat (emri dhe mbiemri, vendi dhe data e lindjes, vendbanimi, numri i amzës dhe numri i letërnjoftimit) e anëtarit të propozuar të Këshillit Mbikëqyrës, të marra nga letërnjoftimi, gjegjësisht kopja e pasaportës së anëtarit të propozuar të Këshillit Mbikëqyrës (personi fizik i huaj). Në shtojcë të të dhënave për anëtarin e propozuar të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet deklaratë e personit se këto të dhëna janë të tij dhe të sakta, të konfirmuar nga personi i autorizuar (noteri).

16.3. Certifikatën për arsimin e lartë të mbaruar të anëtarit të propozuar të Këshillit Mbikëqyrës.

16.4. Pyetësoin e plotësuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të bankës (formulari 1). Nënshkrimi i anëtarit të propozuar të Këshillit Mbikëqyrës, i cili ka plotësuar pyetësoin, duhet të konfirmohet nga personi i autorizuar (noteri). Personi i propozuar është i detyruar të jep përgjigje për secilën nga pyetjet e përfshira në pyetësoin.

16.5. Vërtetimin nga gjykata kompetente ose institucioni tjetër kompetent se kundër personit të propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës nuk është shqiptuar sanksioni kundërvajtës ose dënimi i ndalimit për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

16.6. Arsyetimin nga personi i propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës për mënyrën për të cilën përvoja e tij e fituar do të kontribuojë në kryerjen me sukses të detyrave të tij si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të bankës. Personi i propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës duhet të ketë parasysh përgjegjësitë dhe kompetencat e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të bankës dhe standardet që bankat duhet t'i respektojnë në pajtim me rregullat dhe specifikat e aktiviteteve të tyre.

16.7. Të dhënat nga Regjistri qendror për personat juridik në të cilën personi i propozuar është drejtor, anëtar i organit të menaxhimit ose mbikëqyrjes. Të dhënat duhet të jenë me datë jo më të vjetra se një muaj para datës së parashtrimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit në Bankën Popullore.

16.8. Kopjen e aktit, nëse një akt i tillë është dhënë, organit kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve tjera financiare me të cilin personit të propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës i është dhënë pëlqimi anëtar i organit të bankës ose institucionit financiar.

16.9. Vërtetim nga banka e cila e parashtron kërkesën se anëtar i propozuar nuk është debitor neto i bankës.

16.10. Vërtetimin nga banka se personi i propozuar si anëtar i pavarur i Këshillit Mbikëqyrës dhe personat fizikë lidhur me të:

- nuk janë të punësuar ose nuk janë persona me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë;
- nuk janë aksionerë me pjesëmarrje të kualifikuar në bankë;
- nuk punojnë, gjegjësisht në tre vitet e fundit nuk kanë punuar në shoqëri për auditim e cila në atë periudhë ka kryer auditimin e veprimtarisë së bankës;
- në tri vitet e fundit para datës së parashtrimit të kërkesës nuk kishin interes material ose marrëdhënie afariste me bankën në vlerë e cila mesatarisht në vit tejkalon 3 milionë denarë.

16.11. Banka Popullore sipas detyrës zyrtare nga gjykata kompetente ofron raportimin për (mos)gjykimin e anëtarit të propozuar, në kuptim të nenit 83 paragrafi 2 pika 2-a të Ligjit të Bankave. Nëse personi i cili propozohet për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës është person i huaj, është i detyruar vetë të ofrojë raportimin e tillë nga institucionet kompetente të vendit të huaj.

16.12. Dokumentacionin tjetër që Banka Popullore mund ta kërkojë gjatë procesit të vendimmarrjes nëse personi i propozuar i plotëson kriteret për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, të përcaktuara me Ligjin e Bankave.

17. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për riemërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të bankës (rizgjedhja), banka e dorëzon dokumentacionin të nënpikës 16.1.) (vendimi për riemërim), 16.2.) (nëse ka skaduar vlefshmëria e dokumenteve të dorëzuara më parë ose ka ndodhur ndryshim në raport me të dhënat), 16.4), 16.5), 16.7), 16.8), 16.9), 16.10.) (për anëtarët e pavarur) dhe 16.11.) (për personin fizik të huaj) nga ky vendim, si dhe:

- procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës të mbajtura për periudhën së paku një vit para parashtrimit të kërkesës;

- të gjitha vlerësimet vjetore në punën e vet të personit të propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, të kryera në pajtim me nenin 89, paragrafi (4) të Ligjit të Bankave, gjatë gjithë periudhës derisa ka qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të bankës;

- konfirmimi nga banka nëse personi i propozuar për të qenë anëtar i Këshillit Mbikëqyrës dhe personat lidhur me të përdorin kredi ose forma të tjera të ekspozimit ose kanë depozita në bankë, nuk zbatohen kushtet më të favorshme se ato që vlejnë për klientët e tjerë të bankës në të njëjtin nivel të rrezikut;

- dokumentacion tjetër që mund të kërkojë Banka Popullore gjatë procesit të vendimmarrjes nëse personi i propozuar i plotëson kriteret për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, të përcaktuara nga Ligji i Bankave.

18. Me personin e propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të bankës mund të zbatohet intervistë për shkak të vlerësimit të njohurive të tij të rregullave në fushën e bankës dhe/ose financave, njohjen e bankës në të cilën është propozuar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, të kuptuarit e tij për përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe përvojën e tij.

19. Gjatë vendimmarrjes në lidhje me kërkesën për dhënien e pëlqimit për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pika 16) e këtij vendimi dhe intervistës së bërë, Banka Popullore vlerëson nëse personi i propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrësi plotëson kriteret e përcaktuara me Ligjin e Bankave, gjegjësisht a posedon arsim të lartë, njohjen e rregullave në fushën e bankës dhe/ose financave dhe a ka përvojën dhe reputacionin e duhur me të cilin do të ofrojë veprimtari të sigurt dhe stabile të bankës.

Njohja e rregullave në fushën e bankës dhe/ose financave nënkupton njohjen e Ligjit të Bankave, aktet nënligjore që dalin nga ky ligj, si dhe rregullat dhe praktikat tjera bankare dhe financiare që është e rëndësishme për veprimtarinë e bankave, duke përfshirë dhe njohuri për bankën në të cilën personi propozohet si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, nga aspekti i punës dhe menaxhimit me bankën. Plotësimi i këtij kriteri konfirmohet në bazë të përvojës së mëparshme të kandidatit dhe/ose në bazë të intervistës me kandidatin. Nëse në intervistën kandidati i propozuar nuk tregon njohuri bazë të rregullave në fushën e bankës dhe/ose financave dhe/ose njohuri për bankën, do të konsiderohet se nuk e plotëson këtë kriter.

Personi i propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës do të konsiderohet se ka reputacion të përshtatshëm nëse është i ndershëm, kompetent, punëtor dhe ofron siguri se puna e tij nuk do të rrezikojë stabilitetin dhe sigurinë e bankës dhe nuk do të dëmtojë dukjen dhe besimin e saj. Kjo nënkupton që për këtë person nuk ka dëshmi për përfshirjen e tij të mëparshme në veprimtarinë afariste ose aktiviteteve që nënkuptonin mosrespektimin e rregullave, praktikave dhe procedurave afariste, dëmtimin ose rrezikun e interesave të personit juridik ku ka punuar ose punon dhe për interesat e kreditorëve të tij.

Nëse personi i propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës ka qenë më parë organi i bankës ose në ndonjë bankë tjetër, vlerësohet nëse personi nuk ka respektuar dispozitat e Ligjit të Bankave dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji dhe/ose mosveprimi sipas masave të shqiptuara nga guvernatori, me çka kanë qenë ose janë të rrezikuara stabiliteti dhe siguria e bankës, banka tjetër ose e depozituesve të tyre. Përmes dokumentacionit të dorëzuar dhe dokumentacionit që disponon Banka Popullore, vlerësohet prania, pjesëmarrja dhe kontributi i tij në punën e Këshillit Mbikëqyrës.

Nëse personi i propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës është person i huaj me përvojë si anëtar i organeve të institucioneve financiare, të dhënat e duhura për të përcaktuar përvojën dhe reputacionin e tij mund të kërkohen nga organi mbikëqyrës i vendit prej nga vjen.

20. Në bazë të vlerësimit të kryer në pajtim me pikën 19) të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendimin për të dhënë pëlqimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës ose për të refuzuar kërkesën, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

Banka Popullore mund të japë pëlqimin për personin e propozuar për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të bankës me afat më të shkurtër se afati i përcaktuar në kërkesën, nëse vlerëson se është e nevojshme.

Pas dhënies së pëlqimit për emërimin e personit të propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të bankës, banka është e detyruar t'i dorëzojë Bankës Popullore aktvendim për kryerjen e regjistrimit të personit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktvendimi dorëzohet në afat prej pesë ditëve pas regjistrimit të kryer.

V. DHËNIA E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT DREJTUES

21. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të bankës, banka dorëzon:

21.1. Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të bankës për emërimin e anëtarit të propozuar të Këshillit Drejtues, i cili do të hyjë në fuqi pas dhënies së pëlqimit nga guvernatori. Në vendimin theksohet mandati për të cilën emërohet anëtari i propozuar, duke pasur parasysh dispozitat e statutit të bankës që i referohen në kohëzgjatje të mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues. Vendimit duhet t'i dorëzohet edhe arsyetimi i Këshillit Mbikëqyrës për arsyet e emërimit të personit të propozuar si anëtar i Këshillit Drejtues të bankës, si dhe arsyetimi i përfitimeve për bankën nga emërimi i tij.

21.2. Të dhënat (emri dhe mbiemri, vendi dhe data e lindjes, vendbanimi, numri i amzës dhe numri i letërnjoftimit) e anëtarit të propozuar të Këshillit Drejtues, të marra nga letërnjoftimi, gjegjësisht kopja e pasaportës së anëtarit të propozuar anëtar i Këshillit Drejtues (personi fizik i huaj). Në shtojcë të të dhënave për anëtarin e propozuar të marra nga letërnjoftimi, dorëzohet deklaratë e personit se këto janë të dhëna të tij dhe të sakta, të konfirmuara nga personi i autorizuar (noteri).

21.3. Certifikatë për arsimin e lartë të mbaruar të anëtarit të propozuar të Këshillit Drejtues.

21.4. Pyetësorin e plotësuar për anëtar të Këshillit Drejtues të bankës (formulari 2). Nënshkrimi i personit të propozuar si anëtar i Këshillit Drejtues i cili ka plotësuar pyetësorin duhet të konfirmohet nga personi i autorizuar (noteri). Personi i propozuar si anëtar i Këshillit Drejtues është i detyruar të jap përgjigje secilës prej pyetjeve/kërkesave të përfshira në pyetësorin.

21.5. Dëshmitë për së paku gjashtë vjet përvojë pune në fushën e financave ose bankave ose tre vjet përvojë pune si person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë me punë të përshtatshme për bankën në të cilën emërohet personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues. Si dëshmi e plotësimit të këtij kushti dorëzohet vërtetimi nga personat juridikë ku ka fituar përvojën e nevojshme për anëtar të Këshillit Drejtues në bankë.

21.6. Programin e punës së personit të propozuar si anëtar i Këshillit Drejtues, i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i bankës, për periudhën e mandatit të tij. Programi duhet të përfshijë së paku gjërat e mëposhtme:

- përshkrimin e situatës në të cilën ndodhet banka në të cilën personi propozohet anëtar i Këshillit Drejtues, duke përfshirë përshkrimin e vendit dhe rolit të asaj banke të tregut;
- përshkrimin e aktiviteteve të planifikuara në fushat e veprimtarisë së bankës që do të jenë nën kompetencën e personit të propozuar anëtar i Këshillit Drejtues, në pajtim me aktet interne të bankës, në periudhën e mandatit të tij.

21.7. Vërtetim i vlefshëm për qëndrim dhe leje e vlefshme për punë në Republikën e Maqedonisë (për personin fizik të huaj). Banka është e detyruar të dorëzojë vërtetim të ri për qëndrim dhe leje të punës në Bankën Popullore në afat prej pesëmbëdhjetë ditë nga skadimi i vlefshmërisë së vërtetimit për qëndrim dhe leje të punës, nëse vlefshmëria e ndonjërit prej këtyre dy dokumenteve skadon në periudhën për të cilën personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues ka marrë pëlqimin e guvernatorit.

21.8. Vërtetim nga gjykata kompetente ose institucioni tjetër kompetent se ndaj personit të propozuar anëtar të Këshillit Drejtues nuk është shqiptuar sanksioni apo dënimi i ndalimit për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

21.9. Rekomandimet prej së paku dy personave me përvojë në fushën e bankave dhe/ose financave, prej të cilëve njëri person nuk është person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankën në të cilën personi është emëruar anëtar i Këshillit Drejtues, as nuk është person i lidhur me bankën.

21.10. Arsyetimin nga personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues për mënyrën në të cilën përvoja e tij e fituar do të kontribuojë në kryerje të suksesshme të detyrave si anëtar i Këshillit Drejtues të bankës. Personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë parasysh përgjegjësitë dhe kompetencat e anëtarëve të Këshillit Drejtues të bankës dhe standardet që bankat duhet t'i respektojnë në pajtim me rregullat dhe specifikat e aktiviteteve të tyre.

21.11. Të dhënat nga Regjistri Qendror nëse personi i propozuar është i regjistruar si drejtor, anëtar i organit drejtues apo mbikëqyrës në person juridik. Të dhënat duhet të datojnë jo më shumë se një muaj para datës së parashtrimit të kërkesës për dhënien e pëlqimit në Bankën Popullore.

21.12. Deklaratën e personit të propozuar i cili është drejtor ose anëtar i organit të menaxhimit në personin tjetër juridik, se funksioni i tillë do të ndërpritet menjëherë pas dhënies së pëlqimit nga Banka Popullore për emërimin e tij si anëtar i Këshillit Drejtues të bankës.

21.13. Deklaratën nga personi i propozuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në personin tjetër juridik menjëherë pas dhënies së pëlqimit nga Banka Popullore për emërimin e tij si anëtar i Këshillit Drejtues të bankës, ose dokumentin tjetër të ngjashëm nga i cili do të mund të konfirmohet plotësimi i kriterit që personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues do të jetë në marrëdhënie punë të përhershme në bankë.

21.14. Kopjen e aktit, nëse akti i tillë është dhënë, organit kompetent për mbikëqyrjen e bankave dhe institucioneve të tjera financiare me të cilin personi i propozuar si anëtar i Këshillit Drejtues iu dha pëlqimi për të qenë anëtar i organit të bankës ose institucionit tjetër financiar.

21.15. Banka Popullore, sipas detyrës zyrtare nga gjykata kompetente, ofron vërtetimin për (mos) gjykimin e anëtarit të propozuar, në kuptim të nenit 83, paragrafi (2), pika 2-a) të Ligjit të Bankave. Nëse anëtari i cili është propozuar anëtar i Këshillit Drejtues është person i huaj, është i detyruar vetë të ofrojë raportim të tillë nga institucionet kompetente në vendin e huaj.

21.16. Dokumentacionin tjetër që Banka Popullore do ta kërkojë në procesin e vendimmarrjes.

22. Së paku njëri nga personat e propozuar për anëtarë të Këshillit Drejtues të bankës është i detyruar të dorëzojë vërtetim nga institucioni kompetent për njohjen e gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj qirilik dhe dëshmi se ka vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

23. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për riemërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të bankës (rizgjedhja), banka dorëzon dokumentacionin nga nënpikat 21.1) (vendimi për riemërimin), 21.2.) (nëse ka skaduar vlefshmëria e dokumenteve të dorëzuara më parë ose ka ndodhur ndryshim në lidhje me të dhënat), 21.4.), 21.6.), 21.7.), 21.8.), 21.11.), 21.13.), 21.14.) (nëse anëtari i propozuar i Këshillit Drejtues ka qenë anëtar i Këshillit të Mbikëqyrjes të personit vartës të bankës dhe ka qenë subjekt i vlerësimit të një organi tjetër të mbikëqyrjes) dhe 21.15.) (për personin fizik të huaj), si dhe:

- vërtetimin nga banka se për personin e propozuar anëtar i Këshillit Drejtues dhe personat e lidhur me të përdorin kredi apo forma të tjera të ekspozimit apo kanë depozita në bankën, nuk zbatohen kushtet më të favorshme se ato që vlejnë për klientët e tjerë të bankës në nivel të barabartë të rrezikut;

- dokumentacionin tjetër që Banka Popullore do të kërkojë në procesin e vendimmarrjes.

24. Me personin e propozuar anëtar i Këshillit Drejtues të bankës mund të zhvillohet intervistë, për shkak të vlerësimit të njohurive të tij në rregullat nga fusha e bankës dhe/ose financave, njohuria për bankën në të cilën propozohet anëtar i Këshillit Drejtues, të kuptuarit e tij për përgjegjësitë dhe kompetencat e Këshillit Drejtues dhe përvojën e fituar në fushën e bankave apo financave.

25. Gjatë vendimmarrjes në lidhje me kërkesën për dhënien e pëlqimit për anëtar të Këshillit Drejtues, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pika 21 e këtij vendimi dhe intervistës së zhvilluar, Banka Popullore vlerëson nëse personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues i plotëson kriteret e përcaktuara me Ligjin e Bankave, gjegjësisht nëse posedon arsim të lartë, njohuri të rregullave në fushën e bankës dhe/ose financave dhe nëse ka përvojën dhe reputacionin e duhur me të cilat do të sigurojë veprimtarinë e sigurtë dhe stabile të bankës.

Njohja e rregullave në fushën e bankave dhe/ose financave nënkupton njohjen e Ligjit të Bankave, aktet nënligjore që dalin nga ky ligj, si dhe rregullat dhe praktikat e tjera bankare dhe financiare që është e rëndësishme për punën e bankave, duke përfshirë njohjen e bankës në të cilën personi është propozuar anëtar i Këshillit Drejtues, nga aspekti i sigurimit të kushteve për punën e saj në pajtim me rregullat, si dhe karakteristikat dhe lëvizjet në sistemin bankar në Republikën e Maqedonisë. Plotësimi i këtij kriteri konfirmohet në bazë të përvojës së mëparshme të kandidatit dhe/ose në bazë të intervistës me kandidatin. Nëse në intervistë kandidati i propozuar nuk tregon njohuri për rregullat në fushën e bankave dhe/ose financave dhe/ose situatën në bankë, do të konsiderohet se nuk e plotëson këtë kriter.

Posedimi i përvojës përkatëse e cila vlerësohet së paku përmes:

- përvojë pune të suksesshme gjashtëvjeçare në fushën e financave ose bankave;
- përvojë pune të suksesshme trevjeçare si person me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në bankë me aktivitete të përshtatshme të bankës në të cilën emërohet anëtari i propozuar.

Anëtari i propozuar i Këshillit Drejtues do të konsiderohet se ka reputacion të përshtatshëm nëse ai është i ndershëm, kompetent, punëtor dhe ofron siguri se puna e tij nuk do të rrezikojë stabilitetin dhe sigurinë e bankës dhe nuk do të dëmtojë dukjen dhe besimin e saj. Kjo nënkupton se për këtë person nuk ka dëshmi për përfshirjen e tij të mëparshme në punën afariste ose aktivitete që nënkuptonin mosrespektimin e rregullave praktikave dhe procedurave afariste, dëmtimin ose rrezikun e interesave të personit juridikë ku ka punuar dhe të inetersave të kreditorëve të tij.

Nëse personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues më parë ka qenë anëtar i organit të bankës ose në ndonjë bankë tjetër vlerësohet nëse prej anës së personit ka pasur mosrespektim të dispozitave të Ligjit të Bankave dhe rregullat e sjellura në bazë të këtij ligji dhe/ose mosveprimi sipas masave të shqiptuara nga guvernatori, me të cilat kanë qenë ose janë në rrezik stabiliteti dhe siguria e bankës ose të depozituesve të saj.

Nëse personi i propozuar anëtar i Këshillit Drejtues është person i huaj me përvojë si anëtar i organeve të institucioneve financiare, të dhënat e duhura për përcaktimin e përvojës dhe reputacionit të tij mund të kërkohen nga organi mbikëqyrës i vendit nga vjen.

26. Në bazë të vlerësimit nga pika 25 e këtij vendimi, guvernatori sjell aktvendim për dhënien e pëlqimit anëtar i Këshillit Drejtues ose refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

27. Banka Popullore mund të lëshon pëlqim për personin e propozuar anëtar i Këshillit Drejtues të bankës me afat më të shkurtër se afati i caktuar në kërkesën, nëse vlerëson se është e nevojshme.

28. Pas dhënies së pëlqimit për emërimin e personit të propozuar anëtar i Këshillit Drejtues të bankës, banka dorëzon:

- aktvendimin për kryerjen e regjistrimit të personit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë. Aktvendimi dorëzohet në afat prej pesë ditëve pas kryerjes së regjistrimit;
- dëshminë se personi nuk është më drejtor ose anëtar i organit të menaxhimit të personit tjetër juridik, nëse para dhënies së pëlqimit personi e ka kryer funksionin e tillë. Dëshmia dorëzohet në afat prej pesë ditëve nga regjistrimi i anëtarit të Këshillit Drejtues në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.
- dëshminë se personi ka themeluar marrëdhënie pune të përhershme në bankë si anëtar i Këshillit Drejtues.

VI. DHËNIA E PËLQIMIT PËR THEMELIMIN E DEGËS, FILIALIT APO PËRFAQËSUESES JASHTË VENDIT OSE PËRFITIMI I PJESËS KAPITALE NË BANKË

Themelimi i filialeve ose degëve jashtë vendit

29. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për themelimin e filialit ose degës jashtë vendit, banka dorëzon:

29.1. Vendimin e organit kompetent të bankës për themelimin e degës, gjegjësisht filialit jashtë vendit.

29.2. Elaborimin e arsytimit për themelimin e degës, gjegjësisht filialit jashtë vendit, në të cilën duhet të përpunohen qëllimet, lartësia e kapitalit që investohet (nëse ka investim të tillë), pritshmëritë evidente të lartësisë së rezultatit financiar dhe treguesit financiarë për tre vitet e para nga veprimtaria e degës, gjegjësisht filialit.

29.3. Listën e aksionarëve me pjesëmarrje të kualifikuar në degë, nëse ka aksionarë të tillë.

29.4. Programin e punës që duhet t'i përfshijë së paku aktivitetet financiare që do t'i kryejë dega, gjegjësisht filiali jashtë vendit, si dhe struktura organizative e degës, gjegjësisht filialit.

29.5. Vendin në të cilin do të themelohet dega, gjegjësisht filiali jashtë vendit, si dhe emri i organit mbikëqyrës kompetent.

29.6. Selinë e degës, gjegjësisht filialit jashtë vendit, nga ku mund të merren të dhënat e nevojshme për veprimtarinë e degës, gjegjësisht filialit të bankës.

29.7. Listën e personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në degën, gjegjësisht në filialin jashtë vendit.

29.8. Të dhënat për investimet ekzistuese ose të planifikuara në bankat ose institucionet e tjera financiare në vend ose jashtë vendit.

29.9. Dokumentacionin tjetër që Banka Popullore mund ta kërkojë gjatë procesit të vendimmarrjes nga pika 30 e këtij vendimi.

30. Gjatë vendimmarrjes në lidhje me kërkesën për dhënien e pëlqimit për themelimin e degës apo filialit jashtë vendit, Banka Popullore vlerëson ndikimin që do të ketë themelimi i filialit apo degës jashtë vendit në gjithë veprimtarinë e bankës, nga aspekti i sigurisë së saj dhe punës së qëndrueshme, së paku përmes plotësimit të kriterëve të mëposhtme:

- gjendja financiare e bankës dhe veprimtaria e saj e mëparshme ofrojnë mundësinë e zgjerimit të veprimtarive jashtë vendit, ku banka do t'i respektojë standardet mbikëqyrëse;

- sistemet për kontrollin e brendshëm për raportimin dhe kontabilitetin në degën, gjegjësisht filialin janë adekuate dhe mundësojnë menaxhimin me rreziqet në nivel të bankës ose grupit bankar, anëtar i të cilit është ose do të jetë dega;

- banka mund t'i sigurojë të gjithë informatat dhe të dhënat e nevojshme për përgatitjen e raporteve të saj financiare ose të raporteve financiare të grupit bankar dhe të vendos sistem të kontrollit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave dhe informatave të marra nga dega, gjegjësisht filiali jashtë vendit.

- rregulloret dhe praktikrat e vendit në të cilin është themeluar dega ose filiali tregojnë se Banka Popullore do të jetë në gjendje të kryejë në mënyrë efektive funksionin mbikëqyrës dhe se do të jetë në gjendje të bashkëpunojë me organin mbikëqyrës kompetent të atij vendi në aspekt të respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave për kryerjen e mbikëqyrjes efektive;

- shkalla e harmonizimit të rregullave dhe praktikave të vendit në të cilin është themeluar dega ose filiali me standardet ndërkombëtare në fushën e financave, raportimi financiar dhe kontabiliteti, parandalimi i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, etj., nuk tregon se mund të ekziston rrezik i lartë i cili do të kërcënonte stabilitetin, sigurinë dhe reputacionin e bankës, përkatësisht veprimtarinë e saj në pajtim me rregullat.

Themelimi i zyrës përfaqësuese jashtë vendit

31. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për themelimin e zyrës përfaqësuese jashtë vendit, banka e dorëzon dokumentacionin përkatës nga nënparatë 29.1, 29.5, 29.6 dhe 29.7, si dhe elaboratin për arsyetimin e themelimit të zyrës përfaqësuese jashtë vendit, në të cilin do të përpunohen qëllimet dhe rezultatet e pritura nga themelimi i zyrës përfaqësuese.

Gjatë vendimmarrjes në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, në mënyrë adekuate zbatohen kriteret e përcaktuara në pikën 30 të këtij vendimi.

Fitimi i pjesës kapitale në bankë

32. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesës kapitale në bankë tjetër, banka dorëzon:

32.1. Vendimin e organit kompetent të bankës për fitimin e pjesës kapitale në bankën tjetër, së bashku me arsyetimin e qëllimit dhe arsyetimit të fitimit dhe të dhënat për emrin dhe selinë e bankës në të cilën është fituar pjesa e kapitalit.

32.2. Të dhënat për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e bankës në të cilën është fituar pjesa e kapitalit.

32.3. Deklaratën nga organi kompetent i bankës në të cilën është fituar pjesa e kapitalit, e dhënë me përgjegjësinë e plotë penale dhe materiale, se banka nuk zotëron drejtpërdrejt ose tërthorazi më shumë se 5% të numrit të përgjithshëm të aksioneve të bankës që e fiton pjesën kapitale.

32.4. Të dhënat për investimet ekzistuese ose të planifikuara në bankat ose institucionet e tjera financiare në vend ose jashtë vendit.

32.5. Dokumentacionin tjetër që Banka Popullore mund të kërkojë gjatë procesit të vendimmarrjes nga pika 34 e këtij vendimi.

33. Kërkesën për dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesës së kapitalit në bankën e huaj, që nënkupton fitimin me pjesëmarrje në bankën e huaj, përveç të dhënave nga pika 32 e këtij vendimi, banka dorëzon:

- emrin dhe selinë e bankës së huaj;
- të dhënat për identitetin e aksionarëve të tjerë me pjesëmarrje kualifikuese në bankën e huaj;
- vendin ku ndodhet banka e huaj, si dhe emrin e organit mbikëqyrës kompetent në atë vend;
- raportin e auditimit të bankës së huaj për vitin e fundit, të përgatitur nga shoqëria ndërkombëtare e auditimit;
- të dhënat për shumën e mjeteve vetanake dhe normën e mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës së huaj;
- të dhënat për shumën e aksioneve të mundshme të kapitalit të bankës së huaj në bankat ose institucionet e tjera financiare;
- raportin për aktivitetet financiare dominuese që kryen banka e huaj, për sistemin e saj informativ dhe sistemet për menaxhimin me rreziqet dhe kontrollit të brendshëm, si dhe për planet për harmonizimin e sistemeve të informatave të bankës së huaj me sistemet e bankës vendase që ka parashtruar kërkesë për pëlqim (këtë raport e përgatit vetëm banka që merr kontroll në bankën e huaj).

34. Gjatë vendimmarrjes në lidhje me kërkesën për dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesës së kapitalit në bankën tjetër, Banka Popullore e vlerëson ndikimin që do të ketë fitimi i pjesës së kapitalit në bankën tjetër në gjithë punën e bankës, nga aspekti i punës së saj të sigurt dhe të qëndrueshme, së paku nëpërmjet plotësimit të kriterëve në vijim:

- gjendja financiare e bankës mundëson të realizohet investimi i planifikuar në bankën tjetër, gjatë të cilës banka do t'i respektojë standardet e përcaktuara mbikëqyrëse;
- sistemet e kontrollit të brendshëm për raportimin dhe kontabilitetin mundësojnë menaxhimin me rreziqet në nivel të gjithë grupit bankar, anëtare e të cilit është ose do të jetë banka;
- banka mund t'i sigurojë të gjitha informatat dhe të dhënat e nevojshme për përgatitjen e raporteve të konsoliduara të grupit bankar dhe të vendosë sistem të kontrollit të saktësisë dhe besueshmërisë të të dhënave dhe informatave nga banka në të cilën është fituar pjesa e kapitalit

(në rastet kur ekziston grupi bankar ose në bazë të fitimit të pjesës së kapitalit në bankën tjetër, do të formohet grupi bankar);

- ekzistimi i lidhjeve të ngushta të bankës në të cilën fitohet pjesa kapitale me personat e tjerë nuk e vështirëson kryerjen e mbikëqyrjes efektive;

- rregullat dhe praktikave të vendit në të cilin është fituar pjesa e kapitalit në bankë tregojnë se Banka Popullore do të mund të kryejë në mënyrë efektive funksionin mbikëqyrës dhe se do të mund të realizojë bashkëpunim me organin mbikëqyrës kompetent të atij vendi në aspekt të respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave për kryerjen e mbikëqyrjes efektive (në rastin e fitimit të pjesës së kapitalit në bankën e huaj);

- shkalla e harmonizimit të rregullave dhe praktikave të vendit ku fitohet pjesa e kapitalit në bankën me standardet ndërkombëtare në fushën e financave, raportimi financiar dhe kontabiliteti, parandalimi i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit, etj., nuk tregon ekzistencën e mundësisë së rrezikut të lartë që do të kërcënonte stabilitetin, sigurinë dhe reputacionin e bankës vendase, gjegjësisht punën e saj në pajtim me rregullat (në rastin e fitimit të pjesës së kapitalit në bankën e huaj).

Gjatë vendimmarrjes në lidhje me dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesës së kapitalit në bankë të huaj, Banka Popullore mund të kontaktojë organin mbikëqyrës kompetent të asaj banke të huaj, me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe të dhënave dhe me qëllim të përcaktimit të qasjes së përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupit bankar, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankave.

35. Në bazë të vlerësimit nga pikat 30, 31 dhe 34 të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit për themelimin e degës, filialit ose zyrës përfaqësuese jashtë vendit ose për fitimin e pjesës së kapitalit në bankën tjetër ose për refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

VII. DHËNIA E PËLQIMIT PËR THEMELIMIN OSE FITIMIN E PJESËS KAPITALE NË INSTITUCIONIN FINANCIAR JOBANKAR APO NË INSTITUCIONIN JOFINANCIAR QË ËSHTË MBI 10% TË FONDEVE TË VETA TË BANKËS

36. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për themelimin ose fitimin e pjesës së kapitalit në institucionin financiar jobankar ose në institucionin jofinanciar që është mbi 10% të fondeve të veta të bankës (në tekstin e mëtejshëm: investimet në kapital), banka dorëzon:

36.1. Vendimin e organit kompetent të bankës, së bashku me aryetimin e shkaqeve, qëllimin dhe arsyetimin e investimit kapital.

36.2. Propozim-aktin për themelimin e institucionit (në rastin kur themelohet institucioni).

36.3. Raporti i auditimit ose llogaria vjetore e institucionit në të cilin investohet, për dy vitet e fundit.

36.4. Të dhënat për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin e institucionit në të cilin investohet, si dhe për strukturën e pronësisë së atij institucioni.

36.5. Të dhënat për organet e mbikëqyrjes dhe menaxhimit të institucionit në të cilin investohet.

36.6. Të dhënat për shumën e pjesëve të mundshme të kapitalit të institucionit në të cilin investohet në institucionet e tjera.

36.7. Deklaratën e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, të dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, se me investimin nuk tejkalohen standardet e përcaktuara mbikëqyrëse.

36.8. Deklaratën e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, të dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, për ekzistencën gjegjësisht mosekzistencën e lidhjes me personat e tjerë të cilët janë aksionerë/ortakë ose personat me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta në institucionin në të cilin investohet. Në rast të ekzistimit të lidhjes, jepen të dhënat më të detajuara për personat e lidhur dhe mënyra e lidhjes së bankës me këto persona.

36.9. Dokumentacioni tjetër që mund të kërkohet nga Banka Popullore gjatë procesit të vendimmarrjes nga pika 38 e këtij vendimi.

37. Nëse investimi kapital në institucionin financiar jobankar i mundëson bankës kontrollin e atij institucioni, përveç të dhënave nga pika 36 e këtij vendimi, banka dorëzon edhe:

- të dhënat për veprimtarinë bazë të institucionit financiar jobankar dhe planet e ardhshme të zhvillimit;
- investimet ekzistuese ose të planifikuara në institucionet e tjera financiare dhe jofinanciare në vend ose jashtë vendit;
- të dhënat për vendin në të cilin ndodhet institucioni i huaj në të cilin investohet (nëse bëhet fjalë për investim në institucionin financiar jobankar të huaj);
- të dhënat për organin mbikëqyrës kompetent për veprimtarinë e institucionit financiar jobankar;
- të dhënat për mënyrën e identifikimit, matjes, monitorimit dhe kontrollit të transaksioneve me institucionin financiar jobankar dhe për mënyrën e vendosjes dhe mbajtjes së sistemeve të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut, kontrollit të brendshëm për raportimin dhe kontabilitetin;
- të dhënat për mënyrën e sigurimit të informatave dhe të dhënave të nevojshme për përgatitjen e raporteve të konsoliduara të grupit bankar dhe mënyrën e kontrollit të saktësisë dhe besueshmërisë së informatave dhe të dhënave të marra nga institucioni financiar jobankar.

38. Gjatë vendimmarrjes në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pikat 36 dhe 37 të këtij vendimi, Banka Popullore e vlerëson ndikimin që do të ketë investimin kapital në institucionin financiar ose jofinanciar jobankar në veprimtarinë e përgjithshme të bankës, nga aspekti i veprimtarisë së saj të sigurt dhe të qëndrueshëm, së paku nëpërmjet plotësimit të kriteve të mëposhtme:

- gjendja financiare e bankës mundëson realizimin e investimit kapital të planifikuar, ndërkohë që banka do t'i respektojë standardet e përcaktuara mbikëqyrëse;

- sistemet e kontrollit të brendshëm të raportimit dhe të kontabilitetit mundësojnë menaxhimin me rreziqet të pranishme në nivel të gjithë grupit, anëtar i të cilit është ose do të jetë banka;

- struktura organizative ose e pronësisë së institucionit në të cilën investohet strukturën e pronësisë dhe menaxhimit të institucionit në të cilën investohet nuk ka ndikim negativ në veprimtarinë e bankës;

- ekzistenca e lidhjeve të ngushta të institucionit në të cilën investohet me persona të tjerë nuk e vështirëson kryerjen efektive të mbikëqyrjes;

- banka mund t'i sigurojë të gjitha informatat dhe të dhënat e nevojshme për përgatitjen e raporteve të konsoliduara të grupit dhe të vendos sistem për kontrollin e saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave dhe informatave të marra nga institucioni në të cilin investohet (nëse banka është subjekt i mbikëqyrjes së konsoliduar);

- banka ka sistem të përshtatshëm për menaxhimin me rreziqet, kontrollin e brendshëm, raportimin dhe kontabilitetin për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e transaksioneve me institucionin në të cilin investohet.

- rregulloret dhe praktikat e vendit në të cilin banka fiton pjesë të kapitalit sugjerojnë në atë se Banka Popullore do të mund të kryejë në mënyrë efektive funksionin e saj mbikëqyrës dhe se do të mund të realizojë bashkëpunim me organin mbikëqyrës kompetent të atij vendi nga aspekti i respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave për kryerjen e mbikëqyrjes efikase, zbatimin e administrimit, marrjen e masave të tjera për zgjidhjen e gjendjeve, tërheqjen e pëlqimeve, shfuqizimin e lejes për ndryshimin e statusit ose shfuqizimin e lejes për themelimin dhe veprimtarinë (në rastin e investimeve kapitale në institucionin financiar të huaj jobankar);

- shkalla e harmonizimit të rregullave dhe praktikave të vendit në të cilën investohet me standardet ndërkombëtare në fushën e financave, raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimi i larjes së parave dhe financimit të terrorizmit etj., na udhëzon në mundësinë e ekzistencës së rrezikut të lartë që do të kërcëronte stabilitetin, sigurinë dhe reputacionin e bankës, gjegjësisht veprimtarinë e saj në pajtim me rregullat (në rastin e investimit kapital në institucionin financiar jobankar të huaj dhe jofinanciar).

Gjatë vendimmarrjes në lidhje me dhënien e pëlqimit për fitimin e pjesës së kapitalit në institucion financiar jobankar të huaj, Banka Popullore mund të kontaktojë organin mbikëqyrës kompetent të atij institucioni të huaj, me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe të dhënave dhe me qëllim të përcaktimit të qasjes së përbashkët për mbikëqyrjen e konsoliduar të grupit bankar, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Bankave.

39. Në bazë të vlerësimit të pikës 38) të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit për themelimin ose fitimin e pjesës së kapitalit në institucionin financiar jobankar ose në institucionin jofinanciar, që është mbi 10% të mjeteve të veta të bankës, ose miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

VIII. DHËNIA E PËLQIMIT PËR HAPJEN E ZYRËS PËRFAQËSUESE NË BANKË TË HUAJ

40. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për hapjen e zyrës përfaqësuese në bankë të huaj, banka dorëzon:

40.1. Vendimin e organit kompetent të menaxhimit të bankës së huaj për hapjen e zyrës përfaqësuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

40.2. Certifikatën nga regjistri në të cilin është regjistruar selia e bankës së huaj, ku shihet forma ligjore dhe data e regjistrimit, si dhe të dhënat për strukturën e pronësisë së bankës së huaj.

40.3. Raportin e auditimit për vitin e fundit, të përgatitur nga shoqëria ndërkombëtare e auditimit.

40.4. Elaboratin për arsyetimin për hapjen e zyrës përfaqësuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

40.5. Të dhënat për selinë dhe për personin i cili do ta udheheqë zyrën përfaqësuese.

41. Pas dorëzimit të dokumentacionit nga pika 40 e këtij vendimi, parashtruesi i kërkesës është i detyruar të publikojë synimin për hapjen e zyrës përfaqësuese në gazetë ditore, së paku tre ditë me radhë, dhe konkursi duhet të përmbajë: emrin dhe selinë e zyrës përfaqësuese dhe aktivitetet që do t'i kryejë. Në afat prej pesë ditë nga dita e publikimit, në Bankën Popullore dorëzohet dëshmia për shpalljen e konkursit.

42. Gjatë analizës së kërkesës për dhënien e pëlqimit për hapjen e zyrës përfaqësuese të bankës së huaj, vëmendje e veçantë i kushtohet gjendjes financiare dhe reputacionit të bankës së huaj.

43. Pas kërkesës për hapjen e zyrës përfaqësuese të bankës së huaj, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit ose refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

Në afat prej pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në regjistrin e zyrës përfaqësuese të personave të huaj në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Bankën Popullore dorëzohet dëshmia me shkrim për regjistrimin e kryer. Banka Popullore njoftohet për ndryshimin e selisë dhe personin që udheheq me zyrën përfaqësuese dhe për mbylljen e zyrës përfaqësuese, në afat prej pesë ditëve të punës nga dita e ndryshimit të ndodhur.

IX. DHËNIA E PËLQIMIT PËR NDRYSHIMIN E EMRIT DHE SELISË SË BANKËS

44. Kërkesës për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e emrit dhe selisë së bankës, banka dorëzon propozim-vendim të Këshillit Mbikëqyrës të bankës dhe arsyetim për nevojën dhe qëllimin e ndryshimit të tillë.

45. Nëse kërkohet ndryshimi i selisë, në kërkesën e pikës 44 të këtij vendimi dorëzohen edhe të dhënat për hapësirën afariste ku do të vendoset selia e re (e vet apo e dhënë me qira, vendndodhja, sipërfaqja, etj.) dhe për njësitë organizative të bankës që do të funksionojnë në selinë e re.

Nëse në hapësirat afariste ku do të vendoset selia e re e bankës planifikohet të kryhen aktivitetet financiare për të cilat banka ka marrë pëlqimin e guvernatorit, në kërkesën dorëzohen

të dhënat për sistemin e informatave dhe pajisja teknike e hapësirës afariste për kryerjen e atyre aktiviteteve financiare, të përcaktuara në nënpikën 5.4 të këtij vendimi.

Banka Popullore mund të kryejë inspektim të selisë, nga aspekti i plotësimit të nivelit të nevojshëm të pajisjeve teknike dhe përshtatshmërisë së selisë për kryerjen normale të aktiviteteve financiare.

46. Nëse kërkohet ndryshimi i emrit të bankës, duhet pasur kujdes me emrin e ri të bankës të mos paraqet mundësi konfuzioni në lidhje me identitetin e ndonjë prej institucioneve ekzistuese, si dhe konfuzion në lidhje me identitetin dhe vëllimin e aktiviteteve të bankës që kërkon ndryshimin e emrit.

47. Kërkesës për ndryshimin e emrit dhe selisë së bankës, në Bankën Popullore parashtrohet edhe kërkesë për ndryshimin e statutit të bankës, në pjesën e emrit dhe selisë së bashku me dokumentacionin e parashikuar në pikën 2 të këtij vendimi.

48. Pas kërkesës për ndryshimin e emrit dhe selisë së bankës, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit ose refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

Ndryshimi i emrit dhe/ose selisë së bankës publikohet në gazetën ditore, së paku tre ditë me radhë. Dëshmia për shpalljen e konkursit duhet të dorëzohet në Bankën Popullore, më së voni pesë ditë nga dita e botimit në gazetën ditore.

X. DHËNIA E PËLQIMIT PËR FITIMIN E AKSIONEVE NË BANKË, SHUMA NOMINALE KUMULATIVE E SË CILËS ËSHTË OSE TEJKALON 5%, 10%, 20%, 33%, 50% DHE 75% TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË SHUMËS SË AKSIONEVE, GJEGJËSISHT TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË AKSIONEVE TË EMETUARA ME TË DREJTË VOTE

49. Personi që synon direkt ose indirekt, gradualisht ose papritur, të fitojë aksione në bankë, shuma nominale totale kumulative e së cilës është ose tejkalon 5%, 10%, 20%, 33%, 50% dhe 75% të numrit të përgjithshëm të aksioneve, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i aksioneve të emetuara me të drejtë vote në bankë (në tekstin e mëtejme: fitimi i aksioneve në bankë), është i detyruar në kërkesën për dhënien e pëlqimit të dorëzojë:

49.1. Të dhënat për numrin e aksioneve që personi synon t'i fiton, për numrin e aksioneve që personi mund të zotërojë tashmë në atë bankë, si dhe të dhënat për përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin fillestar të bankës para dhe pas fitimit të aksioneve.

49.2. Dokumentacionin e përshtatshëm të paraparë në nënpikën 2.6. dhe pikat 3,9 dhe 10 të Vendimit për dhënien e lejeve të bankës.

49.3. Pyetësoin e plotësuar për fitimin e aksioneve në bankë (formulari 3 ose 4). Nënshkrimi i personit që ka plotësuar pyetësoin duhet të vërtetohet nga personi i autorizuar

(noteri). Gjatë plotësimit të pyetësorit, është e nevojshme saktë dhe plotësisht t'iu përgjigjeni secilës pyetje.

49.4. Dokumentacionin tjetër që Banka Popullore mund të kërkojë gjatë procesit të vendimmarrjes nga pika 51 e këtij vendimi.

50. Kërkesës për dhënien e pëlqimit, personi që synon të fiton aksione, shuma nominale kumulative e të cilave është së paku 33% nga numri i përgjithshëm i aksioneve, gjegjësisht nga numri i përgjithshëm i aksioneve të emetuara me të drejtë vote, përveç dokumentacionit nga pika 49 e këtij vendimi, dorëzon dhe:

- planin strategjik afarist që duhet t'i përfshin qëllimet, udhëzimet dhe perspektivat e pritura të bankës, si dhe propozimet e mundshme për zgjerimin dhe përmirësimin e veprimtarisë dhe prezencës në treg;

- deklaratën e dhënë me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, të nënshkruar nga personi ose nga organi kompetent i personit (nëse bëhet fjalë për personin juridik), se do të vazhdojë ta mbështesë veprimtarinë e bankës.

51. Gjatë vendimmarrjes në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga pikat 49 dhe 50 të këtij vendimi, vlerësohet nëse personi që synon të fiton aksione në bankë i plotëson kriteret e përcaktuara me Ligjin e Bankave , me çka do të mundësohet banka të jetë e organizuar dhe e aftë të punojë në pajtim me rregullat dhe standardet e përcaktuara mbikëqyrëse, së paku përmes:

- përcaktimit të identitetit të personit që synon të fiton aksione në bankë, personat e lidhur me të dhe formën e tyre ligjore;

- përcaktimit nëse gjendja financiare e personit që synon të fiton aksione në bankë është e përshtatshme në raport me vlerën e aksioneve që synon t'i fiton;

- përcaktimit të burimeve të fondeve, origjinës dhe ligjshmërisë së tyre;

- reputacionit të personit që synon të fiton aksione në bankë. Për personin që synon të fiton aksione në bankë do të konsiderohet se ka reputacion të përshtatshëm nëse është i ndershëm, kompetent, punëtor dhe ofron siguri se me punën e tij nuk do të kërcënon stabilitetin dhe sigurinë e bankës dhe nuk do të dëmtojë dukjen dhe besimin e saj. Kjo nënkupton se për këtë person nuk ka dëshmi për përfshirjen e tij të mëparshme në veprimtarinë afariste ose aktivitete që nënkuptonin mosrespektim e rregullave dhe praktikave dhe procedurave afariste, dëmtimin apo kërcënimin për interesat e personit juridik ku ka punuar ose punon dhe të interesave të kreditorëve të tij, mos respektimin e dispozitave të Ligjit të Bankave dhe rregullat e miratuara në bazë të atij ligji dhe/ose mosveprimi të masave të shqiptuara nga guvernatori, të cilat ishin ose kërcënohet stabiliteti dhe siguria e bankës ose depozituesit e saj. Nëse ky person është person i huaj me përvojë si anëtar i organeve të institucioneve financiare ose aksionar i tyre, të dhënat e duhura për përcaktimin e reputacionit të tij mund të kërkohen nga organi mbikëqyrës kompetent i vendit prej nga vjen.

- vlerësimin e rregullave dhe praktikave të vendit prej nga vjen personi që synon të fiton aksione në bankë, për sa i përket faktit nëse Banka Popullore do të mund të kryejë efektivisht funksionin mbikëqyrës dhe a do të mund të bashkëpunojë me organin mbikëqyrës kompetent të atij vendi, nga aspekti i respektimit të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave për kryerjen e mbikëqyrjes efektive (nëse bëhet fjalë për personin e huaj që synon të fiton aksione në bankën);

- përcaktimit nëse shkalla e harmonizimit të rregullave dhe praktikave të vendit prej nga vjen personi që synon të fiton aksione në bankë me standardet ndërkombëtare në fushën e financave, raportimit financiar dhe kontabilitetit, parandalimit të larjes së parave dhe financimit të terrorizmit etj., na udhëzon në mundësinë e ekzistencës së rrezikut të lartë që do të kërcënonte stabilitetin, sigurinë dhe reputacionin e bankës, gjegjësisht veprimtarinë e saj në pajtim me rregullat (nëse bëhet fjalë për personin e huaj që synon të fiton aksione në bankë);
- përcaktimit nëse në kërkesën ekzistojnë mospërputhje të cilat nuk mund të shpjegohen.

Gjatë vendimmarrjes në bazë të dokumentacionit të dorëzuar të pikës 50 të këtij vendimi, vlerësohet edhe mundësia për mbështetjen e rritjes së planifikuar të fondeve të veta të bankës.

52. Lidhur me kërkesën për dhënien e pëlqimit për fitimin e aksioneve në bankë që personi i fiton në bazë të vendimit të organit kompetent në pajtim me ligjin, dokumentacionin që duhet të dorëzojë ky person dhe procedurën e vlerësimit, në mënyrë përkatëse do të zbatohen dispozitat nga pikat 49, 50 dhe 51 të këtij vendimi.

53. Pas kërkesës nga pikat 49 dhe 52 të këtij vendimi, guvernatori miraton aktvendim për dhënien e pëlqimit ose refuzimin e kërkesës, në afatet e përcaktuara me Ligjin e Bankave.

XI. FORMA E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE INFORMATAVE DHE TË DHËNAVE TË TJERA TË NEVOJSHME PËR ZBATIMIN E VENDIMIT

54. Kërkesat për dhënien e pëlqimeve nga pika 1 e këtij vendimi, banka dorëzon të dhëna për personin e autorizuar për kontakt me Bankën Popullore (emri dhe mbiemri, numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa) dhe dëshmi për pagesën e tarifës për shqyrtimin e kërkesës.

55. Dokumentacioni që dorëzohet në kërkesën për dhënien e pëlqimeve nga pika 1 e këtij vendimi, duhet të jetë në origjinal ose kopje e konfirmuar nga personi i autorizuar (noteri), i nënshkruar nga personi i autorizuar ose nga organi kompetent përkatës, të jetë e pastër, pa korrigjime shtesë dhe në gjuhën maqedonase. Nëse dokumenti që duhet të dorëzohet është në gjuhë tjetër, së bashku me origjinalin dorëzohet edhe përkthimi në gjuhën maqedonase, i konfirmuar nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor.

56. Të gjitha vërtetimet, deklaratat dhe pyetësorët që janë pjesë e dokumentacionit që dorëzohet në kërkesën për dhënien e pëlqimeve nga pika 1 e këtij vendimi duhet të jenë të konfirmuara nga personi i autorizuar (noteri) dhe nuk duhet të jenë më të vjetër se gjashtë muaj para datës së parashtrimit të kërkesës për dhënien e lejes. Të gjitha vendimet që janë pjesë e dokumentacionit nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë muaj para datës së parashtrimit të kërkesës, përveç vendimeve të miratuara nga ansamblea e aksionarëve të cilat nuk guxojnë të jenë më të vjetra se një vit para datës së parashtrimit të kërkesës.

Nëse legjislacioni i vendit prej nga vjen personi i huaj që parashtron kërkesën për pëlqim nga pika 1 të këtij vendimi, ose legjislacioni të vendit në të cilin ai person ka punuar së paku pesë vjet para se të parashtron kërkesën për pëlqim nga pika 1 të këtij vendimi, e rregullon çështjen ndryshe në lidhje me dokumentacionin që dorëzohet në kërkesën, detyrohet të bashkëngjisë:

- ekstrakt të rregullores përkatëse të vendit të huaj ose

- mendimin juridik nga avokati i pavarur që nuk është i angazhuar nga banka përkatëse ose person lidhur me bankën, me ç'rast në mendimin dorëzohet dokumenti që vërteton se bëhet fjalë për avokat të autorizuar në vendin e huaj.

57. Banka Popullore është duke shqyrtuar kërkesën për dhënien e pëlqimit nga pika 1 e këtij vendimi me dokumentacion të plotë. Me dokumentacion të plotë nënkuptohet dokumentacioni i përcaktuar me këtë vendim, dokumentacioni që është kërkuar në mënyrë shtesë nga guvernatori i Bankës Popullore, si dhe dokumentet përkatëse, të dhënat dhe informatat që duhet të merren nga institucionet kompetente vendase dhe të huaja për vendimmarrje të kërkesës.

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës, Banka Popullore mund të përdorë edhe dokumentacionin që disponon ajo për bankën përkatëse, personin juridik ose fizik.

XII. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

58. Dispozitat e këtij vendimi zbatohen në mënyrë përkatëse dhe të shtëpive të kursimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

59. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

60. Për procedurat e filluara para hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të zbatohen dispozitat që kanë qenë të vlefshme në ditën e parashtrimit të kërkesës për marrjen e pëlqimit paraprak në Bankën Popullore.

61. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi për dhënien e pëlqimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/07, 134/07, 139/08 dhe 24/11).

V. nr. 02-15/V-2/2013
10 maj 2013
Shkup

Guvernator
dhe kryesues
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

Formular 1**Pyetësor për anëtar të Këshillit Mbikëqyrës**

1. Të dhënat personale
 - 1.1 Emri dhe mbiemri
 - 1.2 Adresa e banimit
 - 1.3 Adresa në Republikën e Maqedonisë (nëse bëhet fjalë për person të huaj me qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut)
 - 1.4 Data dhe vendi i lindjes
 - 1.5 Shtetësia
 - 1.6 Numri i letërnjoftimit ose numri i pasaportës (për persona fizikë të huaj)
 - 1.7 NVAQ
 - 1.8 Telefoni dhe adresa e emajllit.

2. Të dhënat për arsimin

Institucioni arsimor	Emri i arsimit të fituar	Periudha e arsimit të fituar

3. Të dhënat për kualifikimin, historinë profesionale dhe përvojën

3.1. Theksoni të gjitha vendet e punës dhe /ose funksionet që i keni pasur deri në momentin e plotësimit të pyetësorit, duke filluar nga vendi i fundit i punës.

Periudha prej/deri (muaji/viti)	Emri, selia dhe veprimtaria bazë e punëdhënësit	Vendi i punës/ funksioni (kur dhe ku)

3.2. Theksoni të gjitha trajnimet e fituara në fushën e bankës dhe/ose financave

Emri i trajnimit	Institucioni që e ka kryer trajnimin	Periudha e mbajtjes së trajnimit

4. A ju është shqiptuar sanksioni kundërvajtës ose dënimi i ndalimit për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës? Nëse ju është shqiptuar sanksioni ose dënimi i ndalimit, theksoni të gjitha detajet.

5. A keni qenë i/e dënuar me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë me burgim të pakushtëzuar më shumë se gjashtë muaj, për veprat penale kundër pronës, veprat penale kundër financave publike, qarkullimi pagesor dhe ekonomia, veprat penale kundër detyrës zyrtare, si dhe veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, rasteve të veçanta të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit kompjuterik, përdorimit të dokumenteve me përmbajtje të rreme dhe pseudosekretari të Kodit Penal, për aq kohë sa zgjasin pasojat juridike nga aktgjykimi? Nëse është shqiptuar aktgjykim i tillë, theksoni të gjitha detajet.

6. A jeni ju ose personi lidhur me ju, aksioner, pronar, bashkëpronar ose partner në ndonjë person juridik duke përfshirë edhe bankën në të cilën jeni propozuar si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës? Nëse përgjigjja është konfirmuar, plotësoni dy tabelat në vijim, ku e para plotësohet vetëm për anëtarin e propozuar, ndërsa e dyta për personat lidhur me të.

Emri dhe selia e personit juridik në të cilën anëtar i propozuar ka pjesë të kapitalit dhe/ose aksioneve me të drejtë vote	Përqindja e kapitalit dhe/ose aksionet me të drejtë vote

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri i personit të lidhur	Emri dhe selia e personit juridik në të cilën personi i lidhur ka	Përqindja e kapitalit dhe/ose nga

	pjesë të kapitalit dhe/ose nga aksionet me të drejtë vote	aksionet me të drejtë vote

7. A jeni ju, apo personi i lidhur me ju, anëtar i organit mbikëqyrës ose menaxhimit në personat e theksuar më parë? Nëse përgjigjja është konfirmuese, plotësoni dy tabelat e mëposhtme, e para plotësohet vetëm për anëtarin e propozuar dhe e dyta për personat e lidhur me të.

Emri dhe selia e personit juridik	Organi i mbikëqyrjes ose menaxhimit

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri i personit të lidhur	Emri dhe selia e personit juridik	Organi i mbikëqyrjes ose menaxhimit

8. A jeni anëtar i organit të mbikëqyrjes ose menaxhimit ose në çfarëdo lloji mënyre tjetër keni ndikim në menaxhimin dhe miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste për çdo person tjetër juridik, përveç personave juridikë nga pika 6 e këtij pyetësi? Theksoni ato persona juridikë, organin mbikëqyrës ose menaxhues dhe mënyrën në të cilën keni ndikim.

Emri dhe selia e personit juridik	Organi i mbikëqyrjes ose menaxhimit	Përshkrimi i mënyrës së arritjes së ndikimit

9. A jeni ju dhe/ose persona të lidhur me ju, a keni pasur çfarëdo lloji interesi material apo marrëdhënie afariste me bankën në të cilën jeni propozuar si anëtar i këshillit mbikëqyrës në tre vitet e fundit? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni më shumë detaje rreth llojit dhe shumës së interesit material ose llojit të marrëdhënies afariste.

10. A jeni ju apo personi i lidhur me ju, i lidhur/ e lidhur me person juridik në të cilin merr pjesë banka në të cilën jeni të propozuar/e propozuar anëtar i Këshillit Mbikëqyrës? Nëse përgjigjja është konfirmuese, theksoni personin juridik dhe mënyrën e lidhjes.

11. Nëse jeni përfaqësues i aksionerit/aksionerëve të bankës, cili aksioner ose cilët aksionerë të bankës do të përfaqësoni / do t'i përfaqësoni në Këshillin Mbikëqyrës? Në cilën mënyrë jeni të lidhur me aksionerin/aksionerët?

12. Nëse jeni i propozuar /e propozuar për anëtar të pavarur të Këshillit Mbikëqyrës të bankës, në çfarë mënyre konsideroni se do të mund ta realizoni rolin e tij të pavarur?

13. A jeni person i lidhur me anëtarët e tjerë të Këshillit Mbikëqyrës apo me anëtarët e Këshillit Drejtues të bankës? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni me cilët anëtarë dhe në çfarë mënyre jeni të lidhur.

14. A jeni ju, apo personi i lidhur me ju, të lidhur/ e lidhur me persona të tjerë që, sipas Ligjit të Bankave, konsiderohen persona të lidhur me bankën? Nëse përgjigjja është konfirmuar, plotësoni dy tabelat e mëposhtme, e para plotësohet vetëm për personin fizik dhe e dyta për personat e lidhur me personin fizik.

Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri dhe selia e personit të lidhur me bankën	Mënyra e lidhjes

Emri dhe mbiemri, përkatësisht emri dhe selia e personit të lidhur me personin fizik	Emri dhe mbiemri, gjegjësisht emri dhe selia e personit të lidhur me bankën	Mënyra e lidhjes ndërmjet personave nga kolona 1 dhe 2

15. A është hapur procedurë e falimentimit ndaj personave juridikë në të cilët keni qenë person përgjegjës (drejtor, anëtar ekzekutiv i këshillit të drejtorëve, anëtar i Këshillit Drejtues)? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni të dhëna më të detajuara për aktivitetet, kompetencat dhe përgjegjësitë tuaja në atë person juridik.

16. A është miratuar kundër jush aktgjykim gjyqësor i formës së prerë me të cilën është përcaktuar përgjegjësia juaj për procedurën e hapur të falimentimit? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni të gjitha detajet në lidhje me aktgjykimin gjyqësor.

17. Nëse është e zbatueshme në vendin tuaj, a është hapur procedurë e falimentimit mbi pronën tuaj? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni në detaje të gjitha rrethanat që lidhen me këtë procedurë.

18. A janë marrë masa nga organi mbikëqyrës kompetent, ndaj bankës ose institucionit tjetër financiar në të cilin keni realizuar kontroll, ose keni qenë anëtar i organit të mbikëqyrjes ose menaxhimit, ose në çfarëdolloj mënyre keni ndikuar në menaxhimin dhe në

miratimin e politikave dhe vendimeve financiare dhe afariste? Nëse përgjigjja është konfirmuar, theksoni masat dhe të gjitha detajet në lidhje me zbatimin e tyre.

